

KARTELË INFORMATIVE

AL019011

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licenses të Patentës për Shpikje			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Një marrëveshje licencimi i siguron të licencuarit të drejtat e përdorimit të patentës me autorizimin e Pronarit të saj sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje. Ajo shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në çdo zbatim të shpikjes, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e licencimit.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Marrëveshja e licencimit bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët, në të kundërt ajo është e pavlefshme. Objekt i një marrëveshjeje licencimi mund të jetë aplikimi për patentë ose patenta. Licenca regjistrohet në regjistrin e patentave pasi të jetë paguar tarifa përkatëse. Licencuesi ka të drejtë të fillojë një proces gjyqësor në bazë të marrëveshjes së licencimit, vetëm nëse kjo është e regjistruar në regjistrin e patentave. Licencimi i një aplikimi për patentë ose i një patente ka pasoja ndaj palëve të treta, vetëm pas regjistrimit të saj në regjistrin e patentave. Pavarësisht nga kjo, licencimi ende i paregjistruar ka efekt ndaj palëve të treta, që i kanë fituar nga licenca të drejtat për patentën, pas datës së licencimit, por që ishin në dijeni për licencimin në ditën kur i fituan të drejtat e licencimit.			
4. A jam përfitues?	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka patentë për shpikje.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formular aplikimi për kërkesë regjistrim kontratë license	Aplikanti	Po
	2	Mandat i pagesës së tarifës përkatëse	Banke	Po
	3	Autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës	Aplikanti	Po
	4	Kontratën e licesës e cila duhet të ketë formën e një akti noterial	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Qyteti Tiranë	Adresa Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	Orari E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë 5 000 Lekë	Tarifa shtesë Nuk ka	Tarifa Online	Mënyra e pagesës Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Njoftim			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat, për aq kohë sa është përcaktuar në dokumentin e lëshuar midis palëve.			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al <input checked="" type="checkbox"/>			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar ; VKM Nr.1707 datë 29.12.2008 për Miratimin e rregullores "Për lëshimin e Patentave për Shpikje dhe Modelet e përdorimit" e ndryshuar VKM Nr.883, datë 13.05.2009 "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale" i ndryshuar			